


MORTALITETI NGA NEOPLAZMAT MALINJE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Neoplazmat Malinje me 20-25% ndodhen në vendin e dytë në listën e shkaktarëve të vdekjes në vendet e zhvilluara, pas sëmundjeve kardiovaskulare, të cilat marrin pjesë me mbi 50% në strukturën e mortalitetit. Për momentin kanceri është përgjegjës për 1 në 6 raste të vdekjes në rrafsh global. Për çdo vit me kancer diagnostikohen më shumë se 14 milionë njerëz, dhe deri në vitin 2030 ky numër pritet të rritet në mbi 21 milion.

Në Republikën e Maqedonisë pas sëmundjeve kardiovaskulare neoplazmat malinje janë shkaktari i dytë me radhë i vdekjes. Në vitin 2010 nga kanceri kanë vdekur 3705, ndërsa në vitin 2016 3882 persona, ndërsa shkalla e mortalitetit sillet nga 180,3 në 100000 banorë në vitin 2010 deri më 187,3%000 në vitin 2016.


Diagrami 1: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë, 2010 - 2016



Burimi: Instituti i shëndetit publik

Sipas gjinisë, në vitin 2010 numri i meshkujve të vdekur nga neoplazmat malinje është 2218 me një shkallë prej 215,4 në 100000 meshkuj, ndërsa numri i femrave të vdekura 1487 me një shkallë prej 145,1 në 100 000 femra. Në vitin 2016 tek popullata mashkullore ky numër është 2292 me një shkallë prej 220,8 %000, ndërsa tek popullata femërore ky numër arrin 1590 me një shkallë prej 153,7 %000.

Diagrami 2: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje sipas gjinisë në Republikën e Maqedonisë, 2010 - 2016




Burimi: Instituti i shëndetit publik

Lokalizimet më të shpeshta primare të neoplazmave malinje

Tek meshkujt nga neoplazmat malinje në periudhën nga viti 2010-2016 më të përfaqësuara janë neoplazmat malinje të bronkeve dhe mushkërive me shkallë të mortalitetit e cila sillet nga 64,8 në vitin 2010 deri më 66,9 në vitin 2014 dhe 67,7 në 100 000 meshkuj në vitin 2016.


Diagrami 3: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje të bronkeve dhe mushkërive në Republikën e Maqedonisë tek meshkujt, 2010 - 2016



Burimi: Instituti i shëndetit publik

Tek femrat nga neoplazmat malinje në periudhën nga viti 2010-2016 më të përfaqësuara janë neoplazmat malinje të gjirit. Shkalla e mortalitetit sillet nga 30,0 në vitin 2010 deri më 32,7 në vitin 2016 në 100 000 femra.

Diagrami 4: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje të gjirit në Republikën e Maqedonisë tek femrat, 2010 - 2016



Burimi: Instituti i shëndetit publik

Përgatiti:
Sektori për promovim, analizë dhe mbikëqyrje të sëmundjeve joinfektive